



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 102 datë 04.12. 2025

**PËR MIRATIMIN E NORMATIVAVE TË HARXHIMIT TE DRUVE TË ZJARRIT PËR
SHKOLLAT -KOPËSHTET-ÇERDHE E BASHKISË PËRMET.**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën 04/12/2025, Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr 9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar, Ligji nr 10296 datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin 68/2017 "Per Financat e veteqeverisjes vendore" Urdherit të Kryetarit të Bashkise nr. 502 datë: 20.11.2025 "Për ngritjen e Komisionit për përcaktimin e normativave të druve të zjarrit për ngroje në shkollat, kopështet dhe çerdhet e Bashkisë Përmet", pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Furnizimi me dru zjarri për shkollat-kopështet dhe çerdhet në varësi të Bashkisë Përmet të bëhet për periudhën: 01 Janar 2026 – 15 Mars 2026, dhe periudhën: 15 Nëntor 2026 - 31 Dhjetor 2026.
- 2- Normativat e harxhimit të druve të zjarrit për sobat e shkollave, kopështete në Nj.Ad në varësi të Bashkisë Përmet të jetë: 5 m/st dru për cdo sobë në sezon.
- 3- Normativa e druve të zjarrit për kaldajat e shkollave të Qytetit Përmet të jetë: 0.7 m/st në ditë.
- 4- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë,dhe Turizmit Sektori Juridik/Burimet njerezore, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje dhe Shërbimeve Publike në Nj.Administrative.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI